VENDIM
Nr.1565, datë 26.11.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.107, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.107, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 2 (dy), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR NJË NDRYSHIM NË TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
Sipas vendimit të Këshilli të Ministrave nr.107, datë 3.2.2008
(sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Bashkia: Krujë											
Nr. rendor	Nr.i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja e parcelës	Sipërfaqja që do të pakësohet	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi i juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	101	Krastë Krujë (Ek.P)	Kodër Kallamishte	5	Pyll prodhues	47	40.8	Dru zjarri	mmpau (dppk)	dshp	I mbetet bashkisë 6.2 ha
2	113	Krastë Krujë (Ek.P)	bokë kuqe sheshet	9	Pyll prodhues	25.00	25	Dru zjarri	mmpau (dppk	dshp	